



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM-2016/01

Në mbështetje të Nenit 3, paragrafi 2 pika 6 dhe 11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve (Ligjit për KPM-në), KPM nxjerr:

RREGULLORE PËR SHPËRNDARJEN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

Neni 1 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë përmbajtje audio dhe audio-vizuale. Të sigurojë qasje në shërbimet audio dhe audio-vizuale për të gjithë përdoruesit në baza transparente, objektive dhe jo-diskriminuese. Të mbrojë interesat e të gjithë përdoruesve të shërbimit. Të sigurojë nivelin e cilësisë së shpërndarjes të përmbajtjeve audio dhe audio-vizuale në përputhje me standardet e përgjithshme të pranura në Bashkimin Evropian, si dhe të promovojë konkurrencën në fushën e shërbimeve audio-vizuale, në mënyrë që publikut t'i ofrohen shërbime me kualitet të lartë dhe teknologji të avancuar.

Neni 2 FUSHËVEPRIMI

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen ndaj të gjithë të licencuarve të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë përmbajtje audio dhe audio-vizuale për territorin e Republikës së Kosovës, përveç atyre që shfrytëzojnë brezin radio-difuziv (transmetimet tokësore).

Neni 3 PËRKUFIZIMET

- 1. Operatori i shpërndarjes** – personi juridik i cili shpërndan shërbime mediale audio dhe audio-vizuale për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV, OTT, satelitor dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv tokësor.

- 1.1 Operatori kabllor** – sistem i shpërndarjes së programeve televizive përmes sinjaleve të radio-frekuencave që transmetohen përmes kabllove koaksiale apo atyre me fibër-optike.

- 1.2 Platforma IPTV (Internet Protocol Television)** – platformë teknologjike digjitale, përmbajtja dhe shërbimet audiovizive të së cilës përcillen përmes brezit të gjerë në një rrjet IP të mbyllur dhe të administruar nga një ofrues i shërbimit internet [Internet Service Provider (ISP)], me shpejtësi dhe nivel cilësie të paracaktuar.
- 1.3 OTT Over the Top** – platformë teknologjike digjitale, përmbajtja dhe shërbimet audio-vizuale të së cilës përcillen përmes protokollit IP në një rrjet të hapur dhe që nuk administrohet direkt nga ofruesi i shërbimit. Për ofruesin e këtij shërbimi abonentët janë të identifikueshëm dhe midis tyre lidhet marrëdhënie kontraktuale.
- 1.4 Transmetimi direkt radio televiziv satelitor** – transmetimi i programeve radio- televizive të mbështetura në platforma digjitale satelitore, të destinuara për marrje të drejtpërdrejtë nga publiku i gjerë.
- 2. Ofrues i shërbimit medial** – personi fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audio vizuale të ofruesit të shërbimit medial dhe që përcakton mënyrën e organizimit të tij.
- 3. Shërbimi medial audio-vizual** – shërbim i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.
- 4. Shërbimi medial audio** – shërbim i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimit medial audio dhe parimi kryesor i të cilit është ofrimi i programeve, me qëllim që të informojë, argëtojnë apo edukojë gjithë publikun, përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike. Shërbimi medial audio është ose një radio transmetim apo një shërbim medial audio me kërkesë, apo komunikim komercial në shërbimet mediale audio.
- 5. Video on demand (“Video sipas kërkesës”)** – shërbimet e mediave jolineare audio-vizuale – shërbimi medial audio vizuel që sigurohet nga ofruesi i shërbimeve mediale për programet pamore në çastin e caktuar nga përdoruesi dhe kërkesa e individit e bazuar në katalogun e programeve të zgjedhura nga ofruesi i shërbimit medial.
- 6. Pay-per-view PPV (“Paguaj për të shikuar”)** – shërbim televiziv me pagesë me të cilën një përdorues i një ofruesi të shërbimit televiziv mund të blejë ngjarje të caktuara programore për t’i shikuar nëpërmjet transmetimit privat televiziv.
- 7. Shërbimi Internet TV** – është një shërbim programi audio-vizual që ofrohet përmes protokollit IP në një rrjet të hapur dhe që nuk administrohet direkt nga ofruesi i shërbimit. Qasja në këtë lloj shërbimi është e hapur dhe nuk krijohet marrëdhënie kontraktuale midis ofruesit të shërbimit dhe përdoruesit.
- 8. Shpërndarje** – ofrimi i ofruesve të shërbimit medial përmes operatorëve të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur (me apo pa tel) shpërndajnë përmbajtje audio-vizuale deri tek përdoruesit.

9. **Program** – një pako e fotografive lëvizëse me ose pa zë që përbën një njësi të vetme brenda orarit ose katalogjeve të programeve të vendosura nga ofruesi i shërbimit medial, forma e të cilit është e krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filmat e metrazhit të gjatë, ngjarjet sportive, komeditë, dokumentarët, programet për fëmijë dhe dramat origjinale.
10. **Katalogu i ofruesve të shërbimit medial**– listë e ofruesve të shërbimit medial që shpërndahen si pjesë e shërbimit të ofruar, për të cilat operatori i shpërndarjes ka marrë të drejtën e shpërndarjes.
11. **Përdoruesi** – personi i cili pranon shërbimet mediale audio dhe audio-vizuale përmes operatorit të shpërndarjes në bazë të një marrëveshjeje valide.
12. **Licencë** – leja e dhënë nga KPM-ja për transmetime dhe ritransmetime radio-televizive dhe shërbime mediale audio dhe audio-vizuale.
13. **I Licencuar** - personi juridik të cilit KPM-ja i ka dhënë Licencën për të shpërndarë shërbime mediale audio dhe audio-vizuale.
14. **Këshilli Programor i të Licencuarit** – trup profesional i themeluar nga i Licencuari që vendos për përzgjedhjen dhe renditjen e kanaleve që do të shpërndahen nga operatori i shpërndarjes.
15. **Bartja e obligueshme** – obligimi sipas kritereve të përcaktuara nga KPM për bartjen e shërbimeve mediale audio-vizuale të licencuara nga KPM.
16. **Lista e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale për bartje të obligueshme** – lista të cilën e përpilon KPM sipas kritereve të caktuara dhe përfshinë ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale të licencuara nga KPM.
17. **Lista e kanaleve të para** – lista të cilën e përzgjedh Këshilli Programor i të Licencuarit.
18. **RTK 1** – kanali televiziv i transmetuesit publik të Kosovës në gjuhën shqipe që transmetohet përmes rrjetit tokësorë.
19. **RTK 2** – kanali televiziv i transmetuesit publik të Kosovës në gjuhën serbe që transmetohet përmes operatorëve të shpërndarjes jashtë rrjetit tokësorë.

Neni 4 **E DREJTA E SHPËRNDARJES**

1. I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshjet valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale.
2. Marrëveshjet valide duhet të dorëzohen në KPM, në afat prej shtatë (7) ditësh, para fillimit të shpërndarjes së ofruesve të shërbimit medial nga ana e të licencuarit.

3. I licencuari obligohet që për çdo ndryshim të katalogut të kanaleve, si pjesë përbërëse e Licencës, ta njoftojë KPM-në në afat prej shtatë (7) ditësh para fillimit të shpërndarjes së ofruesve të shërbimit medial bazuar në ato ndryshime.
4. Për shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial i licencuari obligohet të sigurojë marrëveshje me shkrim nga secili ofrues i shërbimit medial apo shoqatave për administrim kolektiv. Shpërndarja e shërbimeve mediale audio-vizuale nuk duhet të fillojë para marrjes së pëlqimit nga KPM.
5. Marrëveshjet mbi të drejtën e autorit që kanë të bëjnë me shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial do të jenë të vlefshme në pajtim me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e përafërta.
6. Marrëveshjet mbi të drejtën e autorit, të referuara në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni, do të pranohen edhe si marrëveshje individuale deri në funksionalizimin e shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave të licencuara nga Zyra për të Drejtën e Autorit pranë Ministrisë së Kulturës.
7. I licencuari mund të fillojë shpërndarjen e kanaleve sipas katalogut të ndryshuar vetëm pas njoftimit me shkrim nga i licencuari dhe aprovimit nga KPM. Katalogu i fundit i kanaleve, i dorëzuar në KPM nga i licencuari, do të merret për bazë gjatë monitorimit dhe vlerësimit të pajtueshmërisë me Licencën e KPM-së.

Neni 5 TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

1. I licencuari ka të drejtë të përcaktojë se çfarë shërbimesh të programeve do të shpërndahen përmes operatorit të shpërndarjes të tij, përveç nëse ajo e drejtë kufizohet nga kjo rregullore.
2. I licencuari ka përgjegjësi për të garantuar se të gjitha shërbimet e programit të shpërndara përmes sistemit të tij të shpërndarjes janë në përputhje me Ligjin për KPM-në dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën përkatëse.
3. Kur i licencuari gjen se një shërbim i programit ka përmbajtje ilegale, i licencuari duhet menjëherë ta ndërpresë shpërndarjen e mëturjeshme të përmbajtjes ilegale dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet.
4. I licencuari, gjatë shpërndarjes së ofruesve të shërbimit medial, duhet të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren e KPM-së për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore, duke ofruar mekanizëm dhe udhëzime të qarta në mënyrë që përdoruesit do të mund të kodojnë secilin kanal që ata dëshirojnë.
5. I licencuari obligohet të njoftojë paraprakisht me shkrim KPM-në për çdo zgjerim të rrjetit të shpërndarjes që ka të bëjë me mbulim shtesë të një komune apo zone kadastrale të caktuar.

6. I licencuari obligohet që të fillojë veprimtarinë për ofrimin e shpërndarjes jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga marrja e vendimit për licencim. Në të kundërtën KPM do të ndërmerr masa për ndërprerje të licencës.

Neni 6

LICENCIMI I OPERATORËVE TË SHPËRNDARJES

Procedurat për aplikim, kushtet dhe kriteret për licencim të operatorëve të shpërndarjes së ofruesve të shërbimit medial, janë të përcaktuara në shtojcën e kësaj Rregulloreje.

Neni 7

BARTJA E LICENCËS

Licenca mund të bartet tek një palë tjetër vetëm pas miratimit paraprak me shkrim nga KPM.

Neni 8

KOHËZGJATJA DHE RIPËRTRITJA E LICENCËS

1. Në pajtim me nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit të KPM-së, kohëzgjatja e licencës për operatorë të shpërndarjes do të jetë 10 vite.
2. Kërkesa për ripërtëritje të licencës duhet të bëhet të paktën gjashtë (6) muaj dhe jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të saj.

Neni 9

BARTJA E OBLIGUESHME

1. Me qëllim të sigurimit të qasjes së publikut në ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale, që ofrojnë përmbajtje programore në interes të përgjithshëm të tyre, dhe në mënyrë që të promovohet dhe sigurohet pluralitet medial, të licencuarit i nënshtrohen obligimit për bartje të obligueshme.
2. Të licencuarit obligohen të shpërndajnë pa kompensim dy kanalet e para televizive të transmetuesit publik (kanalin RTK1 dhe kanalin RTK2) si dhe kanalet tjera komerciale me statusin e bartjes së obligueshme, sipas kriterëve të përcaktuara nga KPM.
3. Ofruesi i shërbimit medial audio-vizual nuk mund ta refuzojë statusin e bartjes së obligueshme të përcaktuar nga KPM-ja.
4. Të licencuarit obligohen të sigurojnë kapacitete teknike për ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale të cilët e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme.
5. Ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale do të sigurojnë bartjen e sinjalit të tyre tek i licencuari për shpërndarje.
6. Të licencuarit do të krijojnë kushte të barabarta për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale të kategorisë bartje e obligueshme, të licencuara nga KPM-ja, dhe trajtim jodiskriminues të tyre.

7. Statusi i bartjes së obligueshme nuk është i zbatueshëm për të licencuarit të cilët operojnë në cilësinë e operatorit satelitor dhe OTT.

Neni 10

KRITERET PËR BARTJEN E OBLIGUESHME

1. Statusin e bartjes së obligueshme në të gjithë operatorët e shpërndarjes e gëzojnë ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale komerciale të licencuara nga KPM të cilat ofrojnë të paktën 25% program gjeneralistik në interes të publikut të gjerë në nivel kombëtar.
2. Statusin e bartjes së obligueshme vetëm në operatorët e shpërndarjes në një komunë respektive e gëzojnë ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale të cilat ofrojnë të paktën 15% program gjeneralistik me interes publik të regjionit respektiv.
3. Kuotat për programin gjeneralistik të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni nuk përfshijnë programet e përsëritura (reprizat).
4. Programi gjeneralistik, i kategorizuar për kualifikim të bartjes së obligueshme, nënkupton programin e shërbimit publik që përbëhet nga lajmet, diskutimet dhe intervistat për çështjet me interes publik, programet edukative aktuale për të rriturit ose fëmijët që kanë nevojë për përkrahje ose ndryshojnë bindje për tema ose modele, argëtime për fëmijë me tema edukative, dokumentarët, programet kulturore, qëllimi kryesor i të cilave është të informojnë e jo të argëtojnë.
5. Bazuar në kriteret e përcaktuara për bartje të obligueshme, KPM do të përpilojë për të licencuarit listën e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale të obligueshme për bartje në platformat e tyre të shpërndarjes.

Neni 11

LISTA E KANALEVE TË PARA

1. Këshilli Programor i të Licencuarit do të vendos për renditjen e kanaleve të para në katalogun e programeve të shpërndara nga i licencuari.
2. Në fillim do të renditen dy kanale televizive të Transmetuesit Publik (RTK1 dhe RTK2).

Neni 12

KANALI INFORMUES

1. I licencuari duhet të krijojë një “kanal informues” i cili, duhet të përdoret vetëm për komunikim me përdoruesit dhe informim të tyre.
2. Ky kanal duhet ekskluzivisht të ofrojë vetëm informacione mbi aktivitetet e të licencuarit që kanë të bëjnë me shpërndarjen e shërbimit, si dhe udhëzimet dhe informatat lidhur me përdorimin e shërbimeve, për të cilat është licencuar të ofrojë programe si operator i shpërndarjes.

3. Të gjitha përmbajtjet e tjera të cilat nuk janë në pajtim me paragrafin 2 janë të ndaluara në kanalin "info", me përjashtim të sfondit audio-muzikor për të cilat i licencuari ka siguruar të drejtat e autorit.
4. I licencuari obligohet që të përditësojë kanalin informues në baza të rregullta për çdo ndryshim që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për të cilat është i pajisur me licencë të KPM-së.
5. I licencuari obligohet që, përmes kanalit informues, në vazhdimësi të ofrojë informacion për përdoruesit lidhur me mënyrën se si mund ta bëjnë bërë ri-programimin e renditjes numerike të programeve të përcaktuar në Nenin 16.3 të kësaj Rregulloreje.
6. I licencuari duhet të krijojë një formë të përshtatshme të komunikimit me përdoruesit e tij dhe në përputhje me kapacitetet e tij teknike, të cilat mund të përfshijnë e-mailin, telefonin dhe forma të tjera të komunikimit.

Neni 13 NDALESAT PËR MODIFIKIM

1. Ofruesit e shërbimet mediale audio-vizuale dhe ofruesit e shërbimeve mediale duhet të shpërndahen të pandryshuara në formën e pranuar dhe pa futjen e komunikimeve komerciale, njoftimeve dhe përmbajtjeve të tjera të ngjashme nga i licencuari.
2. Lejohet futja e informacioneve për ngjarjet e cilësuar si: katastrofa natyrore e humanitare, kërcënim i sigurisë publike dhe përhapja e ndonjë epidemie që rrezikon shëndetin publik, nga institucionet përgjegjëse në pajtim me ligjet e aplikueshme.

Neni 14 KËRKESAT OPERACIONALE PËR TË LICENCUARIN

1. I licencuari është i obliguar të mirëmbajë veprimtarinë e tij në atë mënyrë që të mos i shkaktojë pengesa teknike dhe të dëmshme përdoruesve, ose të pengojë përdoruesit nga përdorimi i shërbimeve nga të licencuarit tjerë.
2. I licencuari, në rastet e ndërprerjes së shërbimeve për shkaqe teknike, obligohet t'ia kompensojë përdoruesit periudhën për aq kohë sa ka pasur ndërprerje.
3. Operatorët e shpërndarjes nuk do të jenë përgjegjës për defektet në funksionimin e shërbimit që ndodhin si rezultat i ndërhyrjeve të paautorizuara dhe të pakoordinuara. Me njoftim paraprak për përdoruesit, operatorët e shpërndarjes rezervojnë të drejtën të ndërpresin ofrimin e shërbimit për arsye të mirëmbajtjes, përmirësimit, modernizimit, apo optimizimit të rrjetit.

Neni 15 PËRDORIMI I SISTEMIT TË QASJES SË KUSHTËZUAR

1. I licencuari që ofron shërbim duke përdorur sistemin e qasjes së kushtëzuar, obligohet që, në çdo rast kur kërkohet nga KPM-ja, t'i dorëzojë udhëzimet e qarta të përdorimit në mënyrë që t'i mundësojë KPM-së kryerjen e kontrolleve dhe monitorimeve.

2. I licencuari që mbulon më shumë se 60% të komunave të Republikës së Kosovës obligohet që për qëllim monitorimi të sigurojë KPM-së sinjalin televizive të pa koduara dhe pa kompensim.

Neni 16

MBROJTJA E PËRDORUESVE

1. I licencuari është i detyruar të nënshkruajë një kontratë me shkrim me përdoruesin. Kontrata duhet të përfshijë kushtet themelore të ofrimit të shërbimit, tarifën themelore të shërbimit dhe tarifën shtesë të pakos dhe shërbimit, mënyrat e pagesës së shërbimit, njoftimin për procedurën e eliminimit të pengesave, kohën e garantuar për eliminimin e pengesave dhe një numër telefoni për të raportuar pengesat, informacion mbi procedurën e parashtrimit të ankesave, kushtet e shkëputjes së shërbimit dhe kushtet për ndërprerje të kontratës.
2. I licencuari duhet po ashtu t'i sigurojë çdo përdoruesi të ri listën e kanaleve për çdo shërbim të programit në dispozicion në sistemin e rrjetit.
3. I licencuari obligohet të sigurojë që përdoruesi të ketë mundësinë të bëjë ri-programimin e renditjes numerike të programeve në pranuesin e rrjetit të cilin e posedon apo shfrytëzon, njësoj sikurse edhe të drejtën e grupimit të programeve apo edhe "kontrollit prindëror" duke filluar pas kanalit informues e deri tek kanali i fundit në kuadër të pakos programore.
4. I licencuari duhet të ofrojë shërbime për të gjithë qytetarët në zonën e shpërndarjes, dhe kjo do të konsiderohet se çdo person që pranon kushtet e vetme dhe jo-diskriminuese ka të drejtë të lidhë një kontratë abonimi për shërbime të ofruara nga i licencuari.
5. I licencuari nuk do t'i kushtëzojë përdoruesit qasjen në shërbimin e ofruar, në bazë të një kontrate, duke i hequr të drejtën e përdoruesit për të përdorur ndonjë shërbim tjetër, të ofruar nga një ofrues tjetër i shërbimit.

Neni 17

KËSHILLI PROGRAMOR I TË LICENCUARIT

1. I licencuari obligohet të themelojë Këshillin Programor, i cili në pajtim me këtë rregullore dhe kapacitetet teknike të operatorit të shpërndarjes vendosë se cilat radio ose TV programe do të ofrohen në operatorin e shpërndarjes. Mandati, përbërja dhe përgjegjësitë tjera të Këshillit do të përcaktohen në një dokument të brendshëm të miratuar nga i licencuari.
2. Dokumentin e brendshëm nga paragrafi 1 dhe aktin e emërimit të anëtarëve të Këshillit Programor të të Licencuarit, përfshirë të gjitha ndryshimet në këtë dokument, i licencuari ia dërgon KPM-së, 15 ditë nga dita e zgjedhjes së tyre.

Neni 18
KËRKESAT TEKNIKE, SHFRYTËZIMI I SPEKTRIT DHE PËRHAPJA E VALËVE

1. Shpërndarja e programeve radio televizive nga i licencuari nuk mund të bëhet duke transmetuar në brezin radio-difuziv (VHF/TV dhe UHF/TV, brezi IV dhe V).
2. I licencuari duhet të ndërtojë dhe mirëmbajë sistemin e rrjetit të shpërndarjes sipas standardeve teknike dhe është përgjegjës për çfarëdo ndërhyrje në frekuencat transmetuese të shkaktuara nga përhapja e valëve përmes sistemit të shpërndarjes. Nëse KPM-ja informohet se një përhapje e tillë e valëve është duke ndodhur, KPM-ja do të njoftojë të licencuarin për të ndërmarr hapat e nevojshëm që brenda 15 ditësh të evitojë ndërhyrjet teknike. Në rast se i licencuari dështon të marr hapat e nevojshëm për evitim të ndërhyrjeve, KPM-ja do të vendos sanksione në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
3. Pajisjet e përdorura për modulim të zërit (volumit) dhe video-sinjalit në rrjetin e operatorëve të shpërndarjes për transmetime audio dhe audio-vizuale duhet të kenë karakteristika teknike sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Neni 19
RAPORTIMI DHE INSPEKTIMI

1. I licencuari duhet të dorëzojë raport vjetor në pajtim me nenin 28 të Ligjit të KPM-së.
2. KPM-ja ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë çfarëdo pjesë të sistemit të rrjetit të shpërndarjes të të licencuarit, të inspektojë dokumentet dhe shënimet që ndërlidhen me licencën e KPM-së, të monitorojë numrin, kualitetin dhe përmbajtjen e të gjitha shërbimeve programore të ofruara nga të licencuarit.
3. Me kërkesë të KPM-së i licencuari obligohet që të ofrojnë të gjitha marrëveshjet mbi të drejtat e autorit si dhe të dhënat e tjera që ndërlidhen me veprimtarinë e shpërndarjes, që janë të përcaktuara me licencë të KPM-së.
4. I licencuari obligohet që të njoftojë me shkrim KPM-në, për çdo ndryshim të të dhënave, nga ato fillestare, mbi bazën e të cilave është pajisur me licencë të KPM-së.

Neni 20
SANKSIONET

1. Për çdo shkelje të kësaj Rregullore KPM do të ndërmerr masat ligjore të përcaktuara me Ligjin për KPM-në.
2. Në raste të veçanta, kur një ofrues i shërbimit medial me programin e vet do të nxisë veprime që cenojnë interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme, KPM do të urdhërojë të licencuarin ta largojë atë menjëherë nga katalogu i ofruesve të shërbimeve mediale.

Neni 21
DISPOZITAT KALIMTARE

1. Të gjithë të licencuarit të cilët në të njëjtën kohë janë edhe ofrues të shërbimit medial, janë të obliguar që në afat prej 6 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore të krijojnë një sistem të ndarë të kontabilitetit në raport me të licencuarin.
2. Statusi i të licencuarve si Ofrues të Shërbimeve Programore, të licencuar bazuar në Rregulloren CIMC-2007/04 për Distribim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë, mbetet i njëjtë sa i përket të drejtës për shpërndarje të përmbajtjeve programore përmes operatorit të shpërndarjes sipas afatit të përcaktuar në licencë.
3. Të gjithë operatorët aktiv të shpërndarjes që operojnë përmes platformës IPTV janë të obliguar që, brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, të aplikojnë për Licencë të KPM-së.
4. Të licencuarit sipas kësaj rregullore, do të paguajnë taksën vjetore për licencë të KPM-së në pajtim me Rregulloren KPM-2014/03.
5. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja CIMC-2007/04 për Distribim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë.

Neni 22
HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Adnan MEROVCI

Kryetar i KPM-së



Datë: 28.07.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM-2016/01

RREGULLORE PËR SHPËRNDARJEN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO DHE AUDIO-VIZUALE

SHTOJCA

PROCEDURAT, KUSHTET DHE KRITERET PËR LICENCIM

Për të ushtruar veprimtari të shpërndarjes së ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale në Kosovë, operatorët e shpërndarjes obligohen të pajisen me licencë nga KPM.

Licenca e obligon të Licencuarin që të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe ligjet tjera relevante të zbatueshme në Republikën e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e KPM-së, si dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së.

Neni 1

PROCEDURAT E APLIKIMIT

1. Për të aplikuar për licencë të KPM-së, parashtruesi i kërkesës duhet të dorëzojë aplikacionin e përcaktuar nga KPM së bashku me materialet tjera mbështetëse në tri (3) kopje, sipas formularit për aplikim (FA1).
2. Kërkesa për licencë mund të parashtrohet në çdo kohë, përveç nëse KPM vendos ndryshe.
3. Licenca mund të lëshohet për secilin person juridik të interesuar, i cili i plotëson kushtet dhe kriteret e domosdoshme, në mënyrë të qartë dhe të detajuar, ashtu siç janë të përcaktuar mbi bazën e ligjit dhe akteve nënligjore.

Neni 2

KUSHTET PËR LICENCIM

1. Kushtet për parashtrimin e kërkesës për licencë të KPM-së për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale janë të njëjta për të gjithë parashtruesit.
2. Kërkesa duhet të parashtrohet sipas formularit për aplikim të përcaktuar nga KPM. Kërkesa do të konsiderohet si e parashtruar kur formulari është plotësuar në mënyrë të qartë dhe është dorëzuar dokumentacioni i nevojshëm i kërkuar/përcaktuar në formular.

3. Parashtruesi i kërkesës për Licencë duhet të paguaj taksën administrative për aplikim siç përcaktohet me akt të veçantë. Taksa administrative është e pakthyeshme, pavarësisht vendimit përfundimtar të KPM-së ndaj parashtrimin të kërkesës për licencë.
4. Parashtruesi i kërkesës për Licencë duhet të jetë person juridik i regjistruar ligjërisht në Republikën e Kosovës, për ushtrimin e veprimtarisë së shpërndarjes së shërbimeve audio apo audio-vizuale.
5. Parashtruesi i kërkesës për Licencë të KPM-së duhet të jetë person juridik i regjistruar në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
6. Përfaqësuesi i personit juridik duhet të ofrojë dëshmi se është shtetas i Republikës së Kosovës.

Neni 3 KRITERET PËR LICENCIM

KPM-ja me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të parashtruara për licencë për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale, do të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

1. Kapaciteti financiar për të zhvilluar veprimtarinë e shpërndarjes së shërbimeve mediale audio-vizuale (dëshmi nga institucionet përkatëse duke ofruar shumat financiare që janë në përputhje me realizimin e planit të biznesit);
2. Planin e biznesit në forma tabelare dhe narrative për 3 vitet e ardhshme;
3. Realizueshmërinë financiare të propozimit të parashtruesit të kërkesës për licencë;
4. Kapacitetin teknik për të ofruar shërbim cilësor, si dhe listën e pajisjeve që do të përdoren për shpërndarje;
5. Dëshmitë se pajisjet për praninë të sinjalit mundësojnë renditjen e kanaleve sipas preferencave të përdoruesve;
6. Dëshmitë mbi gatishmërinë për sigurimin e marrëveshjeve valide për të drejtën e transmetimit, për të gjitha kanalet komerciale që do të jenë pjesë përbërëse e katalogut;
7. Ofrimin e katalogut të kanaleve, të nënshkruar nga kandidati, mbi bazën e së cilës do të lëshohet licenca e KPM-së;
8. Paraqitjen e strukturës organizative si dhe dëshmitë për posedim të stafit profesional për çështje teknike dhe ligjore (diplomë universitare);
9. Dëshmitë mbi mbrojtjen e përdoruesve (të drejtat dhe përgjegjësitë – draft kontratën që do të lidhet në mes të të licencuarit dhe përdoruesit);
10. Përshkrimin e zonës së shërbimit, të paraqitur përmes një harte digjitale (formati A3 kolor), si dhe vijëzimin e shtrirjes së rrjetit kryesor duke filluar nga kokëfundorja (head-end) qendrore dhe nëpër komuna/zona kadastrale, në territorin e Republikës së Kosovës.
11. Dëshmitë nga institucioni përkatës (ARKEP) për leje të shtrirjes së rrjetit për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale.

Neni 4

ARSYET E DISKUALIFIKIMIT PËR LICENCIM

1. Licenca për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdoj t'i jepet:
 - 1.1 partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individ i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike;
 - 1.2 personit juridik i cili menaxhohet nga një individ, i cili është i dënuar në një proces në përputhje me standardet ndërkombëtare, për krimet që kanë të bëjnë me dhunën apo mashtrimin dhe të cilat nuk i janë falur ligjërisht atij ose asaj;
2. Individëve që janë të Zgjedhur ose të Emëruar në një Funkcion të lartë Zyrtar:
 - 2.1 *Individët që kanë pozita drejtuese në një Subjekt Politik:* Dispozitat e Paragrafit 7 do të zbatohen njësoj për të gjithë individët që janë të zgjedhur ose janë të emëruar në një post drejtues brenda një subjekti politik. Të njëjtit nuk mund të bartin pozita udhëheqëse në strukturën organizative të parashtresës për kërkesë për Licencë.
 - 2.2 *Moszbatimi i mëhershëm i Ligjit dhe rregulloreve të KPM-së:* Shkelje serioze dhe të përsëritura të rregulloreve të KPM-së nga një subjekt, i cili është në pronësi, drejtohet ose financohet nga parashtresës për kërkesë, përbënë bazë të mjaftueshme për refuzim të kërkesës për Licencë të re ose për të transferuar apo për aprovimin për marrjen e një pjese të pronësisë. Shkelje të tilla merren si fakte të dështimit të vënies në funksion të një Operatori të Shpërndarjes në pajtueshmëri me Ligjin, përfshirë edhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së.
3. *Paragjykimet:* Nuk do t'i jepet Licencë një organizate ose ndërmarrje komerciale në rast se ndonjëri nga stafi udhëheqës ka qenë i lidhur me shpërndarjen e materialeve që nxisin urrejtje ose diskriminim, ose që denigrojnë persona në bazë të përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, fesë, gjinisë, orientimit seksual ose të paaftësisë fizike.
4. *Fshehja e informatave:* Neglizhimi i një kandidati ose të licencuarit për të ofruar informacione që mund ta bëjnë KPM-në që të refuzojë miratimin për modifikimin ose transferimin e një licence ose të pjesës së pronësisë së një të licencuari, në bazë të kushteve të kësaj Rregulloreje mund të ketë si pasojë dënime të mëvonshme, përfshirë edhe diskualifikimin për marrje të Licencës ose revokimin e Licencës së KPM-së.
5. *Ndryshim i Rrethanave të të Licencuarit:* Çdo ndryshim në gjendjen e zyrtarëve të OJQ-ve ose pronarëve të kompanive që zotërojnë Licencë të KPM-së ose një pjesë të pronësisë, që ka si pasojë diskualifikimin e tyre për Licencë, duhet t'i raportohet KPM-së brenda pesë (5) ditëve pune, nga ndryshimi i gjendjes. Një individ i diskualifikuar mund të shkëputet vetë nga i licencuari brenda 30 ditëve nga koha kur ka arritur në pozitë për diskualifikim, përveç rastit kur KPM-ja lejon një periudhë më të gjatë për të bërë rregullimin. KPM-ja do të kërkojë në këto raste të minimizojë rrezikun e çrregullimit të operimit të të licencuarit.



LISTA E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE PËR BARTJE TË OBLIGUESHME PËRMES OPERATORËVE TË SHPËRNDARJES

Operatorët e shpërndarjes obligohen që në pajtim me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01 të përfshijnë në platformat e shpërndarjes ofruesit e shërbimeve mediale të licencuara nga KPM.

Përveç kanaleve të Transmetuesit Publik, prezantimi i listës së mëposhtme të ofruesve të shërbimeve mediale për bartje të obligueshme nuk prejudikon renditjen e tyre në operatorin e shpërndarjes.

Kanalet e Transmetuesit Publik:

1. RTK1 - Prishtinë
2. RTK2 – Prishtinë

Ofruesit e shërbimeve mediale me mbulim tokësor nacional:

1. TV 21 – Prishtinë
2. KTV - Prishtinë

Ofruesit e shërbimeve mediale përmes operatorëve të shpërndarjes:

1. KLANKOSOVA TV - Prishtinë
2. TRIBUNA CHANNEL - Prishtinë
3. RROKUM TV – Prishtinë
4. TV KIM – (Çagllavicë) - Prishtinë
5. 1st CHANNEL - Prishtinë
6. TV KISS – Mitrovicë

Ofruesit e shërbimeve mediale me mbulim tokësor regjional dhe lokal:

1. TV MITROVICA - Mitrovicë
2. TV BALLKAN - Prizren
3. TV BESA – Prizren
4. TV OPINION - Prizren
5. TV PRIZRENI - Prizren
6. TV DUKAGJINI - Pejë
7. TV HERC – Shtërpç
8. TV ILIRIA - Viti
9. TV LIRIA – Ferizaj
10. TV TEMA - Ferizaj
11. TV MIR - Leposaviç
12. TV MOST – Zveçan
13. TV SYRI VISION-Gjakovë
14. TV PULS - Gjilan
15. TV VALI – Gjilan
16. TV ZOOM – (Shillovë) Gjilan

Ref:1607/868/KPM/am

Prishtinë, 28 korrik 2016